



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1943/ 11 prot.

Datë 29/08/2024

V E N D I M
Nr. 1138/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29/08/2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1044/2024, datë 13.08.2024 për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-12731-07-10-2024, me objekt “Ndërtimi i pritave në bregun e lumit Devoll, në kuadër të mbrojtjes së tokave bujqësore, Bashkia Gramsh”, me fond limit 82,035,740 leke, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 29.07.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gramsh.

Ankimues: Operatori ekonomik “B93 IP” SHPK me NIPT: L522090500 dhe me adresë: Rruga “Margarita Tutulani”, pallati “Kaso”, Apartamenti nr.76, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Gramsh
Adresa: Bulevardi “10 korriku”, Gramsh.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 13.08.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1044/2024, ku vendosi:

- 1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “B 93 II” ShPK për procedurën e prokurimit “Ndërtimi i pritave në bregun e lumit Devoll, në kuadër të mbrojtjes së tokave bujqësore, Bashkia Gramsh”, me fond limit 82,035,740 leke, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 29.07.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gramsh*
- 2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet dhe sqarimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.*
- 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
- 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “B 93 II” ShPK.*
- 5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 3600/2 prot., datë 21.08.2024, protokolluar me tonën nr. 1943/8 prot., datë 23.08.2024, autoriteti kontraktor Bashkia Gramsh, informon se ka zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1044/2024, datë 13.08.2024, si dhe ka publikuar shtojcën mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit në përputhje me vendimin Nr. 1044/2024, datë 13.08.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-12731-07-10-2024, me objekt “Ndërtimi i pritave në bregun e lumit Devoll, në kuadër të mbrojtjes së tokave bujqësore, Bashkia Gramsh”, me fond limit 82,035,740 leke, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 29.07.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gramsh.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 3600/2 prot., datë 21.08.2024, protokolluar me tonën nr. 1943/8 prot., datë 23.08.2024, autoriteti kontraktor Bashkia Gramsh, informon se ka zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1044/2024, datë 13.08.2024, si dhe ka publikuar shtojcën mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit në përputhje me vendimin Nr. 1044/2024, datë 13.08.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-12731-07-10-2024, me objekt “*Ndërtimi i pritave në bregun e lumit Devoll, në kuadër të mbrojtjes së tokave bujqësore, Bashkia Gramsh*”, me fond limit 82,035,740 leke, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 29.07.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gramsh.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike shtojcës së publikuar në SPE, Komisioni vëren se, autoriteti kontraktor ka publikuar shtojcën për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit, nga verifikimi i së cilës konstatohet se ky i fundit nuk ka kryer modifikimet në përputhje të plotë me përcaktimet e pikës III.2.12.5. lidhur me modifikimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.8 “*Aftësitë teknike dhe profesionale*”, të shtojcës 7 “*FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit, në përputhje të plotë me përcaktimet e vendimit Nr. 1044/2024, datë 13.08.2024.

II.2. Në nenin 24 pika 3 e ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “*Komisioni i Prokurimit Publik merr vendime për ankesat e paraqitura para tij dhe nxjerr interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës, të cilat zbatohen për sa janë të vlefshme në vendimmarrjet e ardhshme. Në marrjen e vendimeve mban parasysh, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritetit;*”.

Ndërsa në nenin 118 pika 2 e po këtij ligji parashikohet: “*2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:*

a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësisht të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji;

b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;

c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore;

ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji;

d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik.”

II.2.1. Nga interpretimi në tërësi i dispozitave ligjore të sipërcituara, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se ka një ndarje të qartë mes rolit të tij të parashikuar nga ligji si organi më i lartë i shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike dhe autoriteteve kontraktore si organ

përgjegjës i zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe njëherazi përgjegjës për zbatimin e vendimeve të K.P.P. Gjykimi i themelit të çështjes gjatë vendimarrjes së organit kolegjal bazohet në interpretimin e ligjit dhe vlerësimin e fakteve, provave dhe materialeve të tjera të administruara gjatë shqyrtimit administrativ. Sa më sipër vendimarrja e anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik përbën dhe zgjidhjen në thelb të çështjes nga njëra anë, si edhe efektin detyrues të saj për palët referuar dispozitivit të vendimit. Efekti detyrues shtrihet tek argumentet thelbësore të vendimit, që përbëjnë edhe arsyen e vendimarrjes dhe eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë. Për këtë arsye, Komisioni gjykon se, për modifikimin e dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor duhet të lexojë me vëmendje interpretimet e Komisionit të Prokurimit Publik në vendimin Nr. 1044/2024, datë 13.08.2024 bazën ligjore dhe çdo referencë tjetër të cituar në këtë vendim.

II.3. Lidhur me konstatimet e mësipërcituara, Komisioni ka kërkuar nga autoriteti kontraktor që të heqë kërkesën që operatorët ekonomikë ofertues duhet të disponojnë mjetet si në vijim: *“Kamion me vinc, Fadromë (mjet teknologjik me goma), Dumper (mjet teknologjik me goma), Grejder (mjet teknologjik me goma), Rul ngjeshës me vibrim mbi 15t, Autovinc, RTV - Transportier për mjete të rënda.”*, pasi Komisioni ka gjykuar se është një kërkesë jo në përputhje me natyrën e punimeve objekt prokurimi dhe me relacionin teknik të kryerjes së këtyre punimeve, pasi referuar relacionit teknik të dokumentave të tenderit këto mjete nuk janë të nevojshme për kryerjen e zërave të punimit objekt prokurimi. Në shtojcën e publikuar nga autoriteti kontraktor rezulton se ky i fundit nuk ka kryer modifikimet në përputhje të plotë me përcaktimet e pikës III.2.12.5. lidhur me modifikimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.8 *“Aftësitë teknike dhe profesionale”*, të shtojcës 7 *“FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT”* të dokumentave të tenderit, në përputhje të plotë me përcaktimet e vendimit Nr. 1044/2024, datë 13.08.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit *“Procedurë e Hapur”* me Nr. REF-12731-07-10-2024, me objekt *“Ndërtimi i pritave në bregun e lumit Devoll, në kuadër të mbrojtjes së tokave bujqësore, Bashkia Gramsh”*, me fond limit 82,035,740 leke, pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 29.07.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gramsh.
2. Autoriteti kontraktor të zbatojë plotësisht pikën III.2.12.5. lidhur me modifikimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.8 *“Aftësitë teknike dhe profesionale”*, të shtojcës 7 *“FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT”* të

dokumentave të tenderit, në përputhje të plotë me përcaktimet e vendimit Nr. 1044/2024, datë 13.08.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

